



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.425/1 Prot.

Tiranë, më 28 / 03 / 2019

V E N D I M

Nr. 47, Datë 28 / 03 / 2019

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, mori në shqyrtim ankesën me nr.24, datë 20.03.2019, të O. M, kundër Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, me objekt pretendimin e diskriminimit për shkak “*të gjendjes arsimore*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, O. M shprehet se nga viti 1999-2002 ka kryer studimet e larta në Akademinë Ushtarake “Skënderbej” dhe ka marrë titullin Oficer me gradën N/Toger. Në periudhën 02.04.2007-30.07.2007 ka kryer studimet në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari” për

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

trajnimin profesional të specialistëve me arsim të lartë, si dhe ka kryer një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë shtetit në fushën policore.

Ai citon se, nga muaji Nëntor i vitit 2002 deri në muajin Prill 2008 ka shërbyer si Oficer në Gardën e Republikës së Shqipërisë në detyra të ndryshme, me gradën Toger. Nga muaji Prill 2008 deri në muajin Janar 2014 ka shërbyer si Oficer me gradën N/Komisar në Policinë e Shtetit në detyra të ndryshme.

Me Urdhërin nr.386, datë 27.01.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është përjashtuar nga Policia e Shtetit.

Me Vendimin nr.609, datë 13.10.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë e ka shpallur fajtor për veprën penale të “*zbulimit të akteve apo të dhënave sekrete*”, parashikuar nga neni 295/a-1 i Kodit Penal, duke e dënuar me 150.000 lekë gjobë, vendim i cili është lënë në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit Korçë.

Subjekti ankues pretendon se, bazuar në parashikimet e nenit 69, të Kodit Penal ai është rehabilituar dhe quhet i pa dënuar. Në këto kushte, nëpërmjet shkresës me nr.04 prot., datë 11.04.2018 ai i ka kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit shfuqizimin e Urdhërit nr.386, datë 27.01.2014, të përjashtimit të tij nga Policia e Shtetit.

Me shkresën me nr.311/1 prot., datë 18.04.2018, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit i ka kthyer përgjigje ankuesit, duke e informuar se nuk ka fakte që çojnë në shfuqizimin e këtij akti administrativ dhe për pasojë ai mbetet në fuqi.

O. M shprehet se, lënia në fuqi e këtij Urdhëri përbën pengesë serioze për fillimin e punës nga ana e tij në institucionet shtetërore apo private, të cilat kanë si kriter ndalues “përjashtimin nga Policia e Shtetit”. Ai citon se ndaj tij nuk ka masa ndaluese nga ana e gjykatës për ushtrimin e profesionit apo masë tjetër shtrënguese, dhe se arsimimi dhe trajnimet që ai ka kryer si brenda dhe jashtë Shqipërisë konsistojnë në arsimimin ushtarak dhe policor. Në këto kushte, për sa kohë është në fuqi ky Urdhër, atij nuk i njihet arsimimi dhe trajnimet që ka kryer, duke qenë se nuk mund të aplikojë për punë në institucionet që kanë si kriter ndalues përjashtimin nga policia.

Ankuesi shprehet se nga viti 2014 e në vijim është përballur me dhunë verbale dhe fizike, si dhe kërcënime nëpërmjet telefonit nga persona të cilët i ka proceduar penalisht gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në Policinë e Shtetit dhe për pasojë ai dhe familja e tij ndihen të kërcënuar dhe të rrezikuar.

Në përfundim të ankesës së tij subjekti ankues kërkon nga Komisioneri, të ushtrojë presion ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për shfuqizimin e aktit administrativ nr.386, datë 27.01.2014 me qëllim që t'i mundësohet punësimi në Policinë e Shtetit.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Neni 1 i Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

- Sa i takon kërkesës së ankuesit për shfuqizimin Urdhërit nr.386, datë 27.01.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Komisioneri konstaton se:
 - Nëpërmjet aktit administrativ sipër përmendur është vendosur përjashtimi i ankuesit nga Policia e Shtetit dhe shfuqizimi i këtij akti nuk është në kompetencë për t'u shqyrtuar as nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe as nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sipas nenit 77, pika 5 të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, ankimimi për masat disiplinore (përfshirë edhe atë të përjashtimit nga Policia e Shtetit) bëhet brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për të, drejtpërdrejtë në gjykatë.

Nga viti 2014 e në vijm, ankuesi ka pasur në dispozicion këtë mjet ligjor për të mbrojtur të drejtën e tij të pretenduar, por nuk rezulton që Urdhëri nr.386, datë 27.01.2014, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit të jetë bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor, e për më tepër të jetë shfuqizuar me vendim gjykate.

Përkundrazi, siç pohon edhe vetë ankuesi, përveç masës disiplinore të përjashtimit nga Policia e Shtetit, ndaj tij është filluar procedimi penal dhe është shpallur fajtor. Me Vendimin nr.609, datë 13.10.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë e ka shpallur fajtor për veprën penale të “*zbulimit të akteve apo të dhënave sekrete*”, parashikuar nga neni 295/a-1 i Kodit Penal, pra për një vepër që lidhet me ushtrimin e detyrës në strukturat e Policisë së Shtetit.

Në këto rrethana, pengesa e ankuesit për ripranim në radhët e Policisë së Shtetit vjen si rezultat i parashikimit të nenit 57, pika 3³ dhe nenit 58, pika 1⁴ të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” (të cilët janë shterues përsa i takon rasteve kur punonjësi mund të ripranohet në strukturat e Policisë së Shtetit), ku nuk parashikohet ripranimi në Polici, në ato raste kur punonjësi ka masën disiplinore të përjashtimit nga Policia e Shtetit.

Ky është një parashikim ligjor me fuqi detyruese të përgjithshme dhe nuk mund të konsiderohet diskriminues.

- Sa i takon pretendimit të ankuesit se Urdhëri nr.386, datë 27.01.2014, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, e pengon për të punuar në organe të tjera të sektorit publik apo privat, është i pa argumentuar dhe hipotetik, pasi është e drejtë e ankuesit që në përputhje me ligjin të aplikojë në ato vende dhe pozicione pune, si në sektorin publik dhe atë privat, për të cilat vlerëson se përmbush kriteret ligjore. (Urdhëri sipër cituar është specifikisht ndalues për punësimin e ankuesit në Policinë e Shtetit).
- Sa i takon pretendimit të ankuesit lidhur me faktin që ndihet i kërcënuar dhe i rrezikuar personalisht dhe familjarisht, Komisioneri vlerëson se ai duhet t’i drejtohet instancave

³ “*Një punonjës i Policisë largohet nga Policia nëse dënohet me burgim me vendim gjyqësor të formës së prerë, si dhe kur ndaj tij merret masa disiplinore e përjashtimit nga Policia*”.

⁴ “*Një person i liruar sipas nenit 57, pika 2, shkronjat a), b), c), d), dh) të këtij ligji, mund të ripranohet në Polici kur ka vende vakante në pozicionin për të cilin ai ka kualifikimin e duhur...*”

përgjegjëse që merren me trajtimin e këtyre rasteve, pasi shqyrtimi i një fakti të tillë nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç, 7 dhe 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së O. M, për shkak se është haptazi e pabazuar, për të bërë të mundur një hetim, sipas parashikimit të dispozitave të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Punësim
Shkaku: Gjendja arsimore